



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN  
KËSHILLI BASHKIAK KURBIN

Nr. 908/prot.

Laç, më. 29.2.2024

VENDIM

Nr. 17 datë 23.02.2024

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR 39, DATË 19.12.2023 TË KËSHILLIT BASHKIAK, "PËR MIRATIMIN E PAGËS SË PUNONJËSVE TË BASHKISË KURBIN, NJËSIVE DHE INSTITUCIONEVE NË VARËSI PËR VITIN 2024"**

Bazuar në Ligjin 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 54 pika (ç), Ligjin Nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", (të ndryshuar), në Vendimin nr.241, datë 20.4.2023, Për disa Ndryshime në Vendimin nr.175, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar", (të ndryshuar), në Vendimin nr. 39, datë 19.12.2023 të Këshillit Bashkiak, "Për miratimin e pagës së punonjësve të Bashkisë Kurbin, Njësive dhe Institucioneve në varësi për vitin 2024", si dhe Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr.219, datë 28.12.2023 "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Kurbin, Institucioneve dhe Agjensive në Varësi dhe klasat e pagave për Nëpunësit Civile në Bashki dhe Njësitë Administrative për vitin 2024", pas propozimit nga Kryetaria e Bashkisë dhe nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e datës 23.02.2024:

**VENDOSI:**

1. Tek Qendra Kulturore e Fëmijëve të shtohen 7 (shtatë), instruktorë të jashtëm me kohë të pjesshme me objekt rritjen cilësore të veprimtarisë së Qendrës Kulturore të Fëmijëve (QKF).
2. Paga e tyre të jetë sipas Vendimit nr.241, datë 20.4.2023, të Këshillit të Ministrave.
3. Të lidhen kontratat individuale të punës me instruktorët e jashtëm.
  - Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
  - Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

- Prefektit të Qarkut Lezhë
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore
- Drejtoria e Financës
- Arkivi

SEKRETARI I KËSHILLIT

Arber LEKA

KRYETARI I KËSHILLIT

Edlira LLESHI

Adresa: Lejla Nr.3, Laç,

Tel.0532 22 270 Fax +355 53 222 225

E-mail [bashkikurbin@gmail.com](mailto:bashkikurbin@gmail.com)